



FEDERATA SHQIPTARE E SHAHUT

KAMPIONATI KOMBËTAR INDIVIDUAL 2025 GJYSËMFINALET

15-23 Mars, Tiranë

1. FTESA DHE RREGULLORJA

Federata Shqiptare e Shahut fton të gjithë anëtarët, Klubet dhe Shoqatat e Shahut për të marrë pjesë me sportistët përfaqësues, në Kampionatin Kombëtar Individual, Gjysëmfinalët 2025.

2. RREGULLAT E PËRGJITHSHME

- 2.1. Kjo rregullore përmban mënyrën e garimit, si dhe programin e garës të Kampionatit Kombëtar Individual /Gjysëmfinalët 2025.
- 2.2. Në garat e kampionatit, zbatohen " Rregullat e Shahut FIDE dhe "Rregullorja e garave të Federatës Shqiptare të Shahut".

3. VENDI DHE DATA

3.1. Garat do të zhvillohen në ambientet e Kompleksit "FARI", nga 15 - 23 Mars 2025

4. PJESËMARRJA

4.1 Pjesëmarrësit do të regjistrohen nëpërmjet klubeve dhe shoqatave, ose me konfirmimin e tyre. Afati i fundit për regjistrim, data 14 Mars.

4.2 Ciftimi i Raundit, do të bëhet sipas sistemit zvicerian.

5. PROGRAMI

Data	Ora	Programi
14/03/2025	20:00	Afati i fundit i regjistriëve
15/03/2025	15:00-15:30 15:30-15:50 16:30	Konfirmim I prezences Hedhja e Shortit Round 1
16/03/2025	16:30	Round 2
17/03/2025	16:30	Round 3
18/03/2025	16:30	Round 4
19/03/2025	16:30	Round 5
20/03/2025	16:30	Round 6
21/03/2025	16:30	Round 7
22/03/2025	16:30	Round 7
23/03/2025	10:00	Round 8

6. MENYRA E GARIMIT

- 6.1. Kampionati Kombëtar Individual /Gjysëmfinalët 2025 është organizuar në një turne me 9 raunde, sipas sistemit zvicerian, me anë të programit kompjuterik.
- 6.2. Koha e mendimit, do të jetë 90 minuta + 30 sekonda shtesë, për çdo lëvizje, duke filluar nga lëvizja e parë.
- 6.3. Rezultati për çdo ndeshje, do të jetë: 1 pikë, për fitore; ½ për barazim dhe 0 për humbje.
- 6.4. Në rast barazimi pikësh për kualifikim, do të luhen ndeshje play-off rapid, me 1 takim, me kohë 15 minuta + 10 sekonda për çdo lëvizje, ku përparësinë për gurët e bardhë, e ka lojtari i klasifikuar më mirë.
- 6.5. Në rast se pretendentët janë në numër tek, më i miri në renditje, bën pushim.
- 6.6. Në rast se edhe ky takim del barazim, do të luhet ndeshje Armageddon, ku i bardhi do të ketë 5 minuta në total, pa shtesë, ndersa i ziu do të ketë 4 minuta.
- 6.7. Në rast barazimi, do të kualifikohet lojtari që ka luajtur me të zezat!
- 6.8. Për lojërat e paluajtura "Tie-Break", modifikohet sipas rregullores së FIDE-s
- 6.9. Vonesa prej 30 minutash, nga fillimi i roundit, shkakton humbjen e lojës.

7. KUALIFIKIMET

- 8.1 Kampionati Kombëtar Individual, Gjysëmfinalët 2025, është një fazë kualifikuese për në "Finalët e Kampionatit Kombëtar 2025". Nga ky turne, kualifikohen 5 shahistë.

8.2 Kualifikohen 5 lojtarët të renditur në 5 vendet e para, në renditjen përfundimtare.

8.3 Lojtarët që kualifikohen drejtpërdrejt në fazën finale, sipas vendimit të Federatës, janë:

- Kampioni i Kampionatit Kombëtar 2024
- 3 lojtarët me ELO më të lartë, të shpallur më 1 Mars 2025
- Kampioni Kombëtar U18, i vitit 2025

8. RREGULLA SHITESE

8.1 Mungesa gjatë një roundi, pa njoftuar paraprakisht gjyqtarinë, shkakton përjashtimin nga turneu. Lajmërimi duhet të bëhet para hedhjes së shortit të raundit pasardhës.

8.2 Çdo lojtar që mbaron ndeshjen, konsiderohet spektaror dhe duhet të largohet nga ambienti i zhvillimit të garës.

8.3 Nuk lejohet pirja e duhanin, në ambientet e zhvillimit të garës.

8.4 Nuk lejohen celularët.

8.5 Ndalohet komunikimi i lojtarëve me persona të tjerë.

8.6 Rregullat e Kundërmashtrimit nga FIDE, janë në fuqi.

8.7 Vetëm lojtarët dhe arbitrat, lejohet që të qëndrojnë në ambjentin e zhvillimit të garës, përveç rasteve kur jep leje arbitri.

9. GJYQTARIA E GARËS

1. NA Kristaq Andoni
2. FA Pandi Borova
3. NA Olta Caka

10. Komisioni i Reklamimit

10.1. Komisioni i reklamimit përbëhet nga:

1. IA Marin Çollaku
2. FA Bernard Leka
3. IA Shkelqim Laze

- 10.2. Reklamimi për çështjen, duhet të bëhet jo më shumë se 15 minuta pas përfundimit të turit, me anë të një kërkesë me shkrim ndaj Kryegjyqtarit.
- 10.3. Lojtaret duhet të komunikojnë vetëm me gjyqtaret e gares.

FEDERATA SHQIPTARE E SHAHUT

Organizator: IO Majlinda Pilinci